

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Implementimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për
Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në
Kosovë

Maj, 2011

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
2. HYRJE.....	2
3. PËRPARIMI NË IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT	3
3.1. NIVELI QENDROR.....	4
3.2. NIVELI LOKAL	8
4. PËRFUNDIM	11
5. REKOMANDIMET	12

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

Plani i Veprimit: Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009-2015

ZQM: Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore

Komiteti: Komiteti Ndërmintoror Drejtues

Komisioni për Kulturë: Komisioni për Kulturë dhe Informim

CRPK: Programi i të Drejtave Civile në Kosovë

MKK: Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKRS: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MMPH: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MASHT: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MAPL: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MPMS: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSH: Ministria e Shëndetësisë

MPB: Ministria e Punëve të Brendshme

ZÇK: Zyra për Çështje të Komuniteteve

ZKM: Zyra e Kryeministrit

OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë

Strategjia: Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2009-2015

Grupi Punues: Grupi Punues Teknik

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton aktivitetet fillestare të ndërmarrë nga institucionet e Kosovës - në nivel qendror dhe lokal - për të filluar zbatimin e masave që janë parashikuar me Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2009-2015). Raporti bazohet në aktivitetet e monitorimit të rregullt të Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre të komuniteteve. Për të grumbulluar informatat e nevojshme, OSBE-ja ka bërë intervista me përfaqësues të ministrive gjegjëse, zyra veqeritare, zyrtarëve komunalë, si dhe aktorët ndërkombëtarë e vendorë që punojnë në mbështetje të integritetit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Raporti mbulon periudhën nga dhjetori 2009 deri në shtator të vitit 2010. Ngjarjet si mbyllja e shumëpritur e kampit të kontaminuar me plumb të Çeshmin Lugut në veri të Mitrovicës/Mitrovica, i cili ishte i banuar nga romë e ashkali të zhvendosur, janë përfshirë në këtë raport, përkundër faktit që nuk i përkasin kësaj periudhe të raportimit

Raporti gjen që përkundër hapave që janë ndërmarrë, institucionet e Kosovës kanë ngecur në përmbushjen e zotimeve të tyre për të krijuar kushte për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Në nivel qendror, pas themelimit të mekanizmave për bashkërendim dhe monitorim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, disa ministri kanë ndërmarrë veprime në sektorët e tyre gjegjës. Këta hapa janë ndërmarrë kryesisht në fushën e rregullimit të vendbanimeve joformale dhe mbështetjes për kthimin dhe riintegrimin, por edhe mbrojtjen dhe promovimin e identitetit kulturor të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Megjithatë, ende ka pengesa të konsiderueshme për zbatimin e plotë të Planit të Veprimit, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit të plotë politik, ndarjes së pamjaftueshme të resurseve dhe mungesës së komunikimit adekuat ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal. Duhet të ketë më shumë angazhim për t'u përmbushur të gjithë synimet e Planit të Veprimit deri më 2015. Në nivelin lokal, disa komuna kanë ndërmarrë hapa pozitivë drejt përmbushjes së synimeve të cekur në Planin e Veprimit. Megjithatë, roli dhe angazhimi i shumë komunave mbetet marginal. Në shumë raste, janë akterët e shoqërisë civile, jo komunat, që kanë marrë rol udhëheqës përmes angazhimit të komunitetit dhe përpjekjeve për t'i përmbushur synimet e cekur në Planin e Veprimit.

Në bazë të rezultateve, raporti ofron një sërë rekomandimesh, duke bërë thirrje tek institucionet përgjegjëse për të demonstruar përkushtimin e tyre ndaj përmirësimit të kushteve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe integritetit të tyre në shoqëri. Për këtë qëllim, veprimet me qëllim të fuqizimit dhe pasurimit të mekanizmave të themeluar për udhëzimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit duhet të bëhet prioritet i qeverisë së Kosovës. Për më tepër, duhen ndërmarrë pa vonesë fushata informuese për të siguruar që zyrtarët komunalë, komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe publiku në përgjithësi, duhet të jenë plotësisht të njoftuar me Strategjinë.

2. HYRJE

Romët, ashkalisht dhe egjiptianët i përkasin komuniteteve më të cenuara në Evropë¹. Gjendja e tyre është brengë e veçantë në Kosovë, sepse këto janë ndër grupet më të lëna anash. Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian kanë jetuar tradicionalisht në Kosovë, me vlerësime shifrash që shkojnë deri në 150,000 persona që i përkasin këtyre komuniteteve para konfliktit më 1999.² Sot, besohet që diku mes 35,000 dhe 40,000³ romë, ashkali dhe egjiptian jetojnë në Kosovë.

Më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian,⁴ që mbulon periudhën që nga 2009-a e deri më 2015 (Strategjia).⁵ Një vit më vonë, në dhjetor të vitit 2009, qeveria miratoi edhe Planin e Veprimit për Implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2009-2015 (Plani i Veprimit), duke përcaktuar masat konkrete që do të ndërmerren nga institucionet gjegjëse qendrore dhe lokale, bashkë me orarin e afateve dhe vlerësimet buxhetore për zbatimin e tyre.⁶

Strategjia përmban një analizë të kushteve dhe sfidave specifike me të cilat përballen komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, derisa Plani i Veprimit përcakton masat konkrete që duhen ndërmarrë për t'u ballafaquar me sfidat e identifikuar. Aktivitetet e propozuara me Planin e Veprimit bëjnë pjesë në katër kategori kryesore. Së pari, dokumenti kërkon një tërësi anketash, vlerësimesh dhe studime hulumtuese të orientuara kah plotësimi i mungesave të të dhënave sasiore dhe cilësore mbi gjitha aspektet jetësore të komuniteteve. Së dyti, përvijohen edhe veprimet e politikave pozitive drejt përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike dhe përfaqësuese të të tri komuniteteve, si dhe eliminimit të përjashtimit social të ngulitur thellë me të cilin janë përballur deri tani. Së treti, ndarja e informatave bashkë me aktivitetet e ngritjes së vetëdijes, janë të parashikuara dhe të orientuara kah komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, si dhe shërbyesit civilë dhe publikut në përgjithësi, me qëllim të shpejtimit të procesit të përfshirjes sociale. Përfundimisht, Plani i Veprimit vë theks të veçantë në promovimin e trashëgimisë, kulturës dhe identitetit të të tri komuniteteve.

¹ Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë 2009-2015, faqe 5: "Është fakt i njohur në mbarë Evropën se Romët (dhe Ashkalisht dhe Egjiptianët) kanë qenë të diskriminuar për shkak me radhë. Edhe në ditët e sotme, ata përballen me diskriminim dhe stereotipe racore dhe janë në ciklin e ngushtë të diskriminimit, varfërisë dhe përjashtimit, si dhe mbesin një nga pakicat më të cenueshme në Evropë".

² Shih Këshilli i Evropës, Raporti për Komitetin për Migrim, refugjatë dhe Popullsi, Asambleja Parlamentare: *Gjendja e refugjatëve në periudha të gjata dhe personave të zhvendosur në Evropën Juglindore*, Doc. 11289 rev. 24 maj 2007.

³ Zyra e Kryeministrit, *Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, dhjetor 2008*, f. 7.

⁴ Romët, ashkalisht dhe egjiptianët shohin veten si tri komunitete të ndara. Megjithatë, pasi përballen me sfida të ngjashme në gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, janë hartuar politika gjerësisht të përbashkëta me qëllim të përmirësimit të kushteve të tyre jetësore, nga shumë aktorë ndërkombëtarë dhe vendorë.

⁵ Komponenti arsimor i Strategjisë është miratuar në korrik të 2007-ës dhe mbulon periudhën nga 2007 deri më 2017.

⁶ Hartimi i Strategjisë ishte përpjekje e përbashkët e Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, ministritë gjegjëse, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, bashkë me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. OSBE-ja gjithashtu ka kontribuar në hartimin dhe shqyrtimin e disa aspekteve të së njëjtës. Strategjia dhe Plani i Veprimit janë dhënë në vegëzën në vijim: <http://ëëë.kryeministri-ks.net/zck/?page=2.128> (qasur më 7 prill 2011).

Strategjia dhe Plani i Veprimit që rrjedh nga ajo mëton të nxisë integrimin e tri komuniteteve në sektorët kryesorë të arsimit, punësimit dhe fuqizimit ekonomik, shëndetësisë dhe çështjeve sociale, banimit dhe vendbanimet joformale, kthimit dhe riintegrimin, regjistrimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, sigurisë, policisë dhe drejtësisë, por edhe në media, kulturë dhe informim. Çështjet gjinore dhe mos-diskriminimi, si tema të ndërthurura duhen ngulitur në gjithë sektorët e lartpërmendur.

3. PËRPARIMI NË IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Implementimi efektiv i Strategjisë dhe Planit të Veprimit duhet siguruar nga ministrinë gjegjëse, komunat dhe zyrat relevante brenda Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim të afërt me partnerët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë. Përveç këtyre, Plani i Veprimit parashikon edhe themelimin e një **Grupi Punues Teknik (Grupi Punues) dhe Komitetit Ndërmintoror Drejtues (Komiteti)**, të mandatuar me mbikëqyrjen e përpjekjeve të bashkërenduara të qeverisë në zbatim të kornizës së politikave për Integrimin e Komunitetit Rom, ashkali dhe egjiptian.

Grupi Punues⁷ ka për detyrë të bashkërendojë investimet qeveritare dhe të donatorëve në financimin e çështjeve parësore dhe udhëhiqet nga Drejtori i Zyrës Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZQM)⁸ në Zyrën e Kryeministrit (ZKM). Grupi Punues gjithashtu ka për detyrë të hartojë raportet gjashtëmujore dhe vjetore për dokumentimin e përpjekjeve në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit. Themeluar më 23 korrik 2010, Grupi Punues ka ngecur në respektimin e kërkesave të vendosura me Plan të Veprimit për t'u takuar jo më pak se katër herë në vit, derisa ka dështuar edhe në përgatitjen e raportit të obligueshëm gjashtëmujor.⁹

Komiteti është organ politik i vendosur për të siguruar bashkërendimin mes sektorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë në implementimin e aktiviteteve të parashikuara me Plan Veprimi, si dhe udhëhiqet nga Zëvendës-Kryeministri.¹⁰ Komiteti ka mbajtur takimin e tij themelues më 8 korrik 2010, shtatë muaj pas miratimit të Planit të Veprimit, pa përfaqësuesin e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve¹¹, i cili ishte emëruar në shtator të vitit 2010. Ndër

⁷ Grupi Punues gjithashtu përfshin përfaqësuesit e Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, Agjencisë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian, Agjencisë për Barazi Gjinore, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe donatorëve të jashtëm.

⁸ ZQM-ja funksionon brenda Zyrës së Kryeministrit qysh prej marsit 2002, si dhe ka për detyrë të harmonizojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përgjatë gjitha politikave dhe aktiviteteve të qeverisë së Kosovës.

⁹ Në takimin e dytë të mbajtur në fund të marsit 2011, Grupi Punues raportoi të ishte në procesin e hartimit të raportit vjetor mbi implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, gjë që do të diskutohej në takimin e radhës.

¹⁰ Komiteti gjithashtu përfshin drejtorin e ZQM-së, Drejtorin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve, nga një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, një përfaqësues i Këshillit Konsultativ për Komunitete, si dhe nga një përfaqësues të të tri komuniteteve.

¹¹ Këshilli Konsultativ për Komunitete (Këshilli) vepron në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës. Ai përbëhet nga përfaqësues të komuniteteve dhe të qeverisë me qëllim të avancimit të qasjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë. Ai ofron një mekanizëm për këmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë, si dhe i jep komuniteteve mundësinë për të komentuar për nismat legjislative apo të politikave të përgatitura nga qeveria dhe për të kërkuar përfshirjen e pikëpamjeve të tyre në nismat që në mënyrë specifike prekin komunitetet. Këshilli

rezultatet kryesore të këtij takimi të parë ishte edhe seria e rekomandimeve për përmirësimin e bashkërendimit mes ministrive gjegjëse, këmbimin e informatave dhe afrimin me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe raportimin mbi implementimin e aktiviteteve gjegjëse. Në mars të vitit 2010, ZQM shpalli kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të shoqërisë civile nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Më 26 maj 2010, qeveria emëroi anëtarët nga OJQ-të “Iniciativa 6”, “Qendra e Komitetit Ashkali” dhe “Fahri Vraniqi” për përfaqësim përkatës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Janë shprehur disa dyshime nga anëtarë të komuniteteve sa i përket transparencës së procedurave të përzgjedhjes dhe legjitimitetit të përfaqësuesve të zgjedhur, por nuk janë parashtruar ankesa formale.

Miratimi i Planit të Veprimit në dhjetor të vitit 2009, i cili erdhi tejet vonë për ndarje të fondeve për implementim më 2010,¹² nënkuptonte që ministrinë dhe komunat gjegjëse nuk do të mund të planifikonin fillimin e zbatimit me kohë. Për më tepër, themelimi i Grupit Punues dhe Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit ndodhi në gjysmën e dytë të vitit 2010, gjë që ndikonte negativisht mbi fillimin e procesit. Megjithatë, janë marrë disa masa në nivelin qendror dhe atë lokal, të cilat shqyrtohen më poshtë.

3.1. NIVELI QENDROR

Plani i Veprimit thekson rolin fundamental të institucioneve të nivelit qendror si përgjegjëse për ndërmarrjen e masave për promovimin e integritit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë. Përveç rolit mbikëqyrës dhe bashkërendues që i është lënë ZKM-së, Plani i Veprimit i jep rol të veçantë disa ministrive, në pajtim me sektorët e kompetencave të tyre. Pas kësaj, disa ministri kanë filluar me aktivitete që kanë të bëjnë me zbatimin e Planit të Veprimit. Është shënuar përparim modest në implementimin e iniciativave dhe në fushat e kthimit, rregullimit të vendbanimeve joformale, kulturës dhe arsimit. Në krahasim me to, nuk janë shënuar zhvillime të konsiderueshme në lidhje me punësimin dhe fuqizimin ekonomik, pjesëmarrje dhe përfaqësim, por edhe në fushat e sigurisë, shërbimeve të policisë dhe drejtësisë. Përpjekjet kryesore që janë bërë nga institucionet qendrore janë diskutuar më poshtë.

ZKM-ja, përmes ZQM-së dhe Zyrës për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)¹³, mbetet qendrore për të siguruar bashkëpunimin efikas mes institucioneve gjegjëse, që është e domosdoshme për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Mes shkurtit dhe marsit 2010, dy Zyrat, në bashkëpunim me OSBE-në, organizuan pesë tryeza të rumbullakëta rajonale¹⁴ për të ngritur vetëdijen mbi Planin e Veprimit tek përfaqësuesit e institucioneve komunale dhe të komuniteteve. Ngjarjet tërhoqën rreth 300 pjesëmarrës për t’i diskutuar përgjegjësitë komunale në lidhje me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit dhe mënyrat e mundshme të bashkëpunimit, për të përforcuar përpjekjet e të gjithëve. ZÇK-ja ka

përfshin 28 pjesëtarë, nga të cilët 20 nga komunitetet joshqiptare dhe anëtarët tjerë përfaqësojnë ministrinë përkatëse, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës.

¹² Ligji nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë, 15 qershor 2008. Afati për dorëzimin për miratim të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës është 31 tetori.

¹³ Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) është e themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit me mandat për të kontribuar në bashkërendimin e angazhimeve të qeverisë në zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e komuniteteve dhe për të siguruar se politikat dhe veprimet qeveritare i përmbushin nevojat dhe interesat e komuniteteve.

¹⁴ Tryezat e rumbullakëta janë mbajtur mes 22 shkurtit dhe 3 marsit në Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prizren dhe Istog/Istok.

qenë aktive edhe në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes implementimit të projekteve të orientuara kah rastet më të cenuara socio-ekonomike, si dhe duke ndarë fonde për të shënuar festat që festohen nga këto komunitete. Megjithatë, do të mund të bëhej më shumë për të siguruar shpërndarjen e informatave përmes ministrive dhe komunave gjegjëse, një aspekt qenësor i rolit udhëheqës që i është dhënë ZKM-së.

Plani i Veprimit identifikon **Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)**, **Ministrinë e Shëndetësisë (MSH)** dhe **Ministrinë e Punës dhe Mirëenien Sociale (MPMS)** si tri institucionet kryesore përgjegjëse për arritjen e qëllimeve të parashikuara në sektorin e **arsimit**. Këto ministri janë përgjegjëse për promovimin e një sistemi përfshirës dhe cilësor arsimor në bazë të drejtësisë, barazisë dhe respektimit të larmisë, duke kontribuar kështu në integrimin e plotë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri. Në korrik të vitit 2010, MASHT-i miratoi kurrikulën në gjuhën rome, duke e bërë Gramatikën Rome dhe Kulturën e Historinë Rome lëndë zgjedhore gjatë vitit shkollor 2010/2011.¹⁵ Më 2 korrik 2010, MASHT-i nisi një tender tremujor për hartimin e librave gjegjës shkollorë, i cili skadoi më 2 tetor 2010. Kjo do të thoshte që publikimi do të bëhej pas fillimit të vitit shkollor. Edhe pse MASHT-i kishte identifikuar 25 mësimdhënës të gramatikës, kulturës dhe historisë rome, nuk është ofruar trajnim specifik për t'i mbështetur ata në detyrat e tyre, derisa janë mbajtur vetëm katër takime vetëdijesuese në Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane dhe Prizren, për të inkurajuar prindërit që t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në lëndët e specializuara. Tryezat e rrumbullakëta me prindër për përgjegjësitë e tyre në lidhje me arsimin e detyrueshëm janë mbajtur në bashkëpunim me Komitetin Arsimor të Prindërve të Kosovës në disa komuna¹⁶ derisa mbështetje është ofruar për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian që kanë vështirësi specifike në gjuhë dhe mësimnxënie.¹⁷ Si pjesë e politikës së MASHT-it në lidhje me gjithë fëmijët e shkollës fillore, 3,399 ashkali, 1,067 Egjiptian dhe 941 romë kanë marrë libra shkollorë pa pagesë për vitin 2009/2010. Sipas zyrtarëve të MASHT-it, për të njëjtin vit shkollor, 158 nxënës dhe 44 studentë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian kanë fituar bursa në shumë prej 150,00 Eurosh, si rezultat i një projekti të implementuar në bashkëpunim me **Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK)** dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Përkundër hapave pozitivë të theksuar më lart, nuk ka shembuj pozitivë të aktiviteteve të zhvilluara apo zbatuara në lidhje me qasjen ndaj edukimit para-shkollor, organizimin e orëve plotësuese apo shkollave verore. Ngjashëm, nuk janë organizuar punëtori apo trajnime për mësimdhënësit, ndërsa, përkundër parashikimit me Plan të Veprimit, nuk janë ofruar programe trajnimi për prindër e mësimdhënës mbi identifikimin dhe parandalimin e rasteve të mundshme të segregimit dhe diskriminimit.

Brenda sektorit të **shëndetit dhe çështjeve sociale**, Plani i Veprimit kërkon përmirësim të gjendjes sociale dhe shëndetësore, cilësisë së shërbimeve dhe qasjes në sistemin shëndetësor dhe social të Kosovës, pa diskriminim, për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian. Për të arritur këtë qëllim, Plani i Veprimit i jep rol udhëheqës **MSH-së** dhe **MPMS-së**, derisa

¹⁵ Më 21 qershor 2010, MASHT-i nxori Udhëzimin Administrativ nr. 7/2010, që fuste kurrikulën rome në sistemin arsimor të institucioneve të Kosovës.

¹⁶ Prizren, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane dhe Pejë/Peç.

¹⁷ Nga 36 të fëmijë të kthyer të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të identifikuar nga MASHT-i, 16 fëmijë kanë marrë pjesë në orë të gjuhës shqipe të ofruara nga MASHT-i. Veç kësaj, MASHT-i ka identifikuar pesë fëmijë me nevoja të veçanta nga këto komunitete, si dhe hartoi plane individuale për t'i ofruar mbështetje në pilot-projekte për vitin shkollor 2010/2011.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është në krye të promovimit të mjedisit të shëndoshë dhe kushteve të qëndrueshme sanitare. Por, i vetmi aktivitet që është ndërmarrë në mënyrë specifike për përmirësimin e qasjes së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve ndaj mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore është themelimi i një grupi punues teknik në MSH. Sipas parashikimit në Planin e Veprimit, grupi punues teknik është i mandatuar të grumbullojë informata mbi kushtet shëndetësore të pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Por, grupi punues është takuar një herë gjatë periudhës së raportimit, derisa asnjë nga aktivitetet e parashikuara, duke përfshirë këtu edhe publikimin e hulumtimit dhe krijimin e bazës së të dhënave për nevojat e komuniteteve, nuk është kryer – pohohet që për shkak të pengesave financiare brenda MSH-së. Që nga korriku 2010, MPMS-ja ka ofruar mbështetje të asistencës sociale për 2,252 familje rome, ashkali dhe egjiptiane, duke përfshirë edhe përjashtimin nga pagesa e faturave të energjisë elektrike deri në një shumë.¹⁸ Në periudhën janar-qershor 2010, njëzet familje rome, ashkali dhe egjiptiane kanë përfituar nga skema e asistencës emergjente në vlerë prej 100-300 Euro në vit, e cila ofrohet në rastet e katastrofave natyrore dhe kushteve skajshmërisht të vështira të jetesës. Përveç këtyre, MPMS-ja ka ofruar vendqëndrim njëjavor për 47 persona romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe transportimin tek komuna e prejardhjes për 74 persona romë, ashkali dhe egjiptian që janë riatdhesuar me dhunë.

Kur bëhet fjalë për **banimin dhe vendbanimet joformale**, Plani i Veprimit kërkon të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në vendbanime joformale, qendra kolektive dhe kushte joadekuate të banimit. Plani i Veprimit përcakton role kryesore në këtë sektor për **MMPH-në, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe MKK-në**. Për të promovuar rregullimin e vendbanimeve joformale, kryesisht të banuar nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, MMPH-ja inicioi, gjatë marsit 2010, procesin e hartimit të Strategjisë për Identifikimin dhe Rregullimin e Vendbanimeve Joformale¹⁹, në përputhje me Planin e Veprimit dhe disa instrumente tjera vendore dhe ndërkombëtare.²⁰ Një shembull pozitiv i rregullimit në vazhdimësi është projekti në vendbanimin Ali Ibra/Kolonia në komunën e Gjakovës/Đakovica, më qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës për 140 familje Egjiptiane, rome, ashkali, serbe dhe shqiptare.²¹

Për të ofruar kushte optimale për mundësimin e **kthimit dhe riintegrit**, përfshirë edhe **riatdhesimin** e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë, Plani i Veprimit i beson role kryesore **Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), MKK-së, MAPL-së, MMPH-së** si dhe **ZKM-së** përmes **ZQM-së** dhe **ZÇK-së**. MKK-ja është vërtetuar të jetë mes institucioneve më aktive në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit, duke përmbushur me

¹⁸ Sipas marrëveshjes mes MPMS-së, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe Korporatës Energjetike të Kosovës, familjet që janë përfshirë në skemën e asistencës sociale kanë të drejtë subvencionimi deri në 500 KVVh energji elektrike në muaj.

¹⁹ Projekt-Strategjia për Identifikimin dhe Rregullimin e Vendbanimeve Joformale, hartuar nga një grup punues i themeluar nga MMPH-ja, u prezantua më 10 mars 2011, për të mbetur e hapur për 30 ditë në vijim për komente publike. Dokumenti mund të gjendet në faqen në vijim: http://www.ks.gov.net/mmph/neëeb/dph/Strategjia_dhjetor_shqip.pdf (qasur më 7 prill 2011).

²⁰ Shih Ligjin nr. 03/L-106 për ndryshimin/plotësimin e Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14, 25 nëntor 2008. Gjithashtu, shih *Deklaratën e Vjenës mbi Politikën dhe Programet Shtetërore dhe Rajonale për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore*, Konferencën Ministrore për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore Vjenë, 28 shtator – 1 tetor 2004.

²¹ Projekti mbështetet bashkërisht nga ZÇK-ja, komuna e Gjakovës/Đakovica dhe Caritas-i zviceran. Projekti, i cili pritet të finalizohet deri në mes të vitit 2012, synon të zhvendosë përfituesit nga toka shoqërore drejt 3.85 hektarëve të tokës komunale të ndarë nga Kuvendi Komunal i Gjakovës/Đakovica, si dhe të mbështesë edukimin dhe integrimin e tyre ekonomik.

sukses obligimin e saj për mbledhjen e kërkesave për kthim vullnetar në një bazë të dhënash. Për më tepër, që prej miratimit të Planit të Veprimit, MKK-ja ka kontribuar, përmes buxhetit dhe me mbështetjen e donatorëve, në organizimin e aktiviteteve të kthimit, duke përfshirë riparimin apo rindërtimin e shtëpive për rreth 160 familje romë, ashkali dhe egjiptiane. Aktivitetet tjera mbështetëse përfshinin edhe ofrimin e paketave të mbështetjes dhe implementimin e projekteve të vogla me qëllim të përmirësimit të qëndrueshmërisë së projekteve të kthimit. Përveç këtyre, 511 romë, ashkali dhe egjiptian (160 gra), kanë marrë pjesë në Vizita Shko-dhe-Shih, 608 (135 gra) në vizita Shko-dhe-Informohu²² dhe 173 (21 gra) kanë marrë pjesë në grupe punuese komunale në komunat e tyre të prejardhjes.²³ Aktivitetet tjera përfshinin ndarjen e shumës prej 50,000 Euro për implementimin e një projekti me qëllim të rregullimit të vendbanimit joformal Ali Ibraj / Kolonia në komunën e Gjakovës/Đakovica, kryesisht i banuar nga komuniteti Egjiptian, si dhe dhurimin e shumës prej 200,000 Euro, në bashkëpunim me ZÇK-në, për mbështetje banesore në lagjen Dubrava në Ferizaj/Uroševac. MKK-ja gjithashtu ka inkurajuar komunën e Mitrovicës/Mitrovica që të ndajë për shfrytëzim 99-vjeçar tokë në Mëhallën e Romëve për romët dhe ashkalitë që banonin në kampet e kontaminuara me plumb në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica.²⁴ Megjithatë, nuk janë ndarë burime buxhetore për t'i ofruar trajtim mjekësor banorëve që i janë ekspozuar plumbit që prej përfundimit të rivendosjes në pjesën jugore të qytetit.²⁵ MKK-ja ka avokuar gjithashtu për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për romët e zhvendosur që aktualisht banojnë në kampin e komunës së Leposavić/Leposaviqit, të cilët nuk kanë përfitur ndonjë ndihmë të tillë deri tani.

Sfidat më të konsiderueshme mbeten të tilla kur bëhet fjalë për ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e riatdhesuar nga vendet e Evropës Perëndimore. Sa i përket kësaj, MPB-ja ende nuk ka themeluar një bazë të dhënash për menaxhimin e rasteve për personat e riatdhesuar me forcë. Një këshill koordinues ndërministror,²⁶ me detyrë të mbikëqyrjes së

²² Vizitat Shko-dhe-Shih i ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë që të marrin informata të dorës së parë mbi kushtet në vendin e tyre të origjinës si dhe të angazhohen e të takohen direkt me komunitetin pranues për të marrë vendime të informuara për kthimin e tyre apo zgjidhje tjera të qëndrueshme. Ata fitohen të vizitohen shtëpitë e tyre dhe të takohen me fqinj, anëtarë komuniteti dhe institucione lokale si pjesë e një vizite të organizuar për të diskutuar çështjet e interesit të veçantë, si ndihma në rindërtimin e shtëpive, punësimi dhe mundësitë e krijimit të të ardhurave, siguria dhe liria e lëvizjes, mirëqenia sociale dhe pensionet, arsimi dhe shërbimet tjera publike. Vizitat Shko-dhe-Informohu bëhen në vendin e zhvendosjes, gjatë së cilës komunitetet e zhvendosura marrin informata mbi gjendjen në vendin e tyre të origjinës dhe vendeve të mundshme të kthimit, duke përfshirë kushtet socio-ekonomike, sigurisë, lirisë së lëvizjes, si dhe mbi procedurat e kthimit dhe mekanizmat e mbështetjes në dispozicion. Shih edhe UNMIK/IPVQ, Doracak i Rishikuar për Kthimin e Qëndrueshëm, korrik 2006.

²³ Aktivitete të tilla janë kryer nga MKK-ja në bashkëpunim me komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Departamentin Amerikan të Shtetit – Zyra Shtetërore e Popullsisë, Refugjatëve dhe Migrimit, si dhe Këshilli Danez për Refugjatë.

²⁴ Më 6 prill 2010, Kryeministri shpërndau një letër për të gjithë kryetarët e komunave duke kërkuar “të ndajnë tokën për shfrytëzim afatgjatë për të kthyerit dhe projekte ndërkombëtare të kthimit për 99 vjet, siç parashikohet me ligj, për të garantuar qëndrueshmërinë e procesit të kthimit”. Më 16 korrik 2010, MKK-ja i dërgoi letër kryetarit të Mitrovicës/Mitrovica, duke e ftuar atë të ndante tokën për 99 vjet në Mëhallën Rome për banorët e kampeve të kontaminuara me plumb në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Megjithatë, komuna dështoi të kryente atë zotim.

²⁵ Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian financoi dy programe me qëllim të mbylljes së kampeve të kontaminuara me plumb Qeshmin Lug dhe Osterode, në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Më 1 shkurt 2011, ceremonia që shënoi mbylljen e Qeshmin Lugut u mbajt, derisa 39 familjet e mbetura romë dhe shkali në kampin e Osterodes priten të zhvendosen në Mëhallën Rome deri në fund të korrikut 2011.

²⁶ Bordi Koordinues nuk synon veçanërisht komunitetet romë, shkali dhe egjiptian, por nevojat e gjithë personave të riatdhesuar.

zbatimit të Strategjisë së Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar,²⁷ është themeluar në nivel të Sekretarëve të Përhershëm brenda ministrive, por nuk përfshin përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

Përfundimisht, Plani i Veprimit i jep rolin **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)** në mbrojtje dhe promovimin e **identitetit kulturor dhe trashëgimisë së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian**. Siç parashikohet me Planin e Veprimit, MKRS-ja ka themeluar Komitetin²⁸ për Kulturën dhe Informimin (Komiteti për Kulturën), me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane, në proceset e politikë-bërjes dhe zbatimit të politikave në fushën e kulturës. Janë bërë përpjekje edhe për rritjen e përfaqësimit të tri komuniteteve brenda MKRS-së.²⁹ Përveç kësaj, MKRS-ja ka financuar pesë projekte të organizatave jo-qeveritare romë, ashkali dhe egjiptiane me një shumë të përgjithshme prej 5,650 si dhe ka siguruar fonde prej 17,144 Eurosh për projektet që synojnë promovimin e identitetit kulturor të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.³⁰ Në korrik dhe gusht të vitit 2010, Zëvendës Ministri për Kulturë, Rinie dhe Sport vizitoi disa komuna me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së këtyre komuniteteve në fushat e kulturës, rinisë dhe sporteve.

3.2. NIVELI LOKAL

Në bashkëpunim dhe në mbështetje të nivelit qendror, komunat janë institucionet kryesore lokale përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe programeve të parashikuara me Planin e Veprimit. Por, në nivel komunal, vetëdija në lidhje me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit është tejet e kufizuar, duke pasqyruar një mungesë të bashkërendimit mes gjithë faktorëve dhe mungesën e komunikimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij komunal.³¹ Nuk janë dhënë udhëzime zyrtare për institucionet e nivelit lokal në lidhje me implementimin e këtyre dokumenteve. Për më tepër, komunat nuk janë kërkuar të ndajnë fonde për zbatimin e Planit të Veprimit në planet e tyre buxhetore për vitin 2011. Kështu, asnjë nga komunat nuk i ka dorëzuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave kërkesa specifike në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit. Është e arsyeshme që të konkludohet se mungesa e financimit dëmton realizimin e aktiviteteve buxhetore në vitin 2011, si dhe mund të dëshmojë për një mungesë përkushtimi të institucioneve të Kosovës në lidhje me zotimet që i kanë marrë bërë me miratimin e Strategjisë. Megjithatë, përkundër kësaj mungese të vetëdijes dhe bashkërendimit, disa komuna pavarësisht dhe në mënyrë proaktive kanë bërë hapa pozitivë drejt përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara me Planin e Veprimit, të cilat përshkruhen si më poshtë.

²⁷ Qeveria e Kosovës, Strategjia e Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar, prill 2010.

²⁸ Komiteti është themeluar me vendimin e MKRS-së nr. 1377/2010 si dhe është takuar për herë të parë më 24 qershor 2010. Ai përbëhet nga gjashtë anëtarë, duke përfshirë nga një përfaqësues të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, si dhe tre zyrtarë nga MKRS.

²⁹ Komisioni për Kulturë ka zgjedhur tre studentë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian për praktika tremujore në departamente të ndryshme të MKRS-së.

³⁰ MKRS, *Plani i Punës për Implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, nga institucionet e nivelit qendror*, objektivi 2: “promovimi i identitetit kulturor të tri komuniteteve përmes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe mbështetjes së aktiviteteve kulturore”.

³¹ Disa zyrtarë komunalë i kanë kërkuar ekipeve të OSBE-së në terren që t’iu sigurojnë kopjet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, pasi kanë raportuar që të mos i kenë marrë ato.

Për sa i përket **pjesëmarrjes në sistemin arsimor**, Plani i Veprimit synon të sigurojë një përmirësim të konsiderueshëm për anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Në një numër rastesh,³² institucionet e nivelit lokal kanë bërë disa hapa drejt këtij synimi. Për shembull, zyrtarët komunalë në bashkëpunim, apo të mbështetur nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare, kanë ndërmarrë fushata me qëllim të ngritjes së vijimit të shkollës nga nxënësit romë, ashkali dhe egjiptian, duke parandaluar mungesat përmes themelimit të kanaleve zyrtare të komunikimit mes shkollave dhe familjeve.³³ Megjithatë, ende mbetet shumë për t'u bërë. Për shembull, në periudhën e raportimit, nuk ka pasur veprime specifike për të promovuar qasjen në shkolla për vajzat e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

Në lidhje me **punësimin dhe fuqizimin ekonomik**, qëllimi kryesor i Planit të Veprimit është që të përmirësojë gjendjen ekonomike të komuniteteve, përmes hartimit të politikave për lehtësimin e qasjes së tyre ndaj tregut të punës. Një numër i vogël komunash kanë ndërmarrë iniciativa punësimi duke pasur për cak këto komunitete.³⁴ Për më tepër, një numër romësh, ashkalish dhe egjiptianësh janë të punësuar në kompani publike, ku pagat e tyre paguhen bashkërisht nga komuna dhe donatorët e jashtëm.³⁵ Sa i përket **shëndetësisë dhe çështjeve sociale**, institucionet e nivelit lokal kanë qenë pak më proaktive. Për shembull, një numër komunash kanë organizuar fushata vetëdijesimi,³⁶ derisa disa të tjerë kanë bërë vizita në terren tek vendbanimet e banuara nga këto komunitete, ose kanë qendra shëndetësore të vendosura brenda apo afër vendbanimeve, duke ofruar mbështetje në baza ditore.³⁷ Për më tepër, duke respektuar një numër rekomandimesh të dhëna nga përfaqësuesit e komuniteteve, si dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës në vendbanime të banuara nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, një numër komunash kanë zbatuar projekte infrastrukturore mu në këto vendbanime specifike.³⁸ Në lidhje me **banimin dhe vendbanimet joformale**, Plani i Veprimit mundohet të gjejë zgjidhje banesore për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në qendra kolektive dhe në kushte joadekuate banimi. Por, në kohën e raportimit, vetëm komuna e Istogut/Istok dhe Klinës/Klina kishin themeluar grupe pune për vlerësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, derisa vetëm Istogu/Istok kishte hartuar raportin me rekomandimet për hapat e nevojshëm në përmirësimin e tyre.

³² Zhvillime pozitive janë vërejtur në Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prizren, dhe Rahovec/Orahovac.

³³ Kjo është arritur përmes një numri aktivitetesh si fushatat derë-më-derë dhe shtypjen e shpërndarjen e fletushkave.

³⁴ Komuna e Rahovecit/Orahovac informoi që në vjeshtë të vitit 2009, një marrëveshje e nënshkruar me një kompani private mundësoi punësimin sezonal të 50 personave, meshkuj e femra, nga vendbanimi Ali Ibraj/Kolonia, derisa një marrëveshje e ngjashme pritet të nënshkruhet edhe këtë vit. Në rajonin e Prizrenit, një numër romësh, ashkalish dhe egjiptianësh janë të punësuar në kompani pastrimi. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Istog/Istok dhe Novo Brdo/Novobërdë, një numër i anëtarëve të këtyre komuniteteve është i punësuar në veprimtari rindërtimi të shtëpive në vendbanime të banuara nga këto komunitete.

³⁵ Në Mitrovicë/Mitrovica, kompania publike "Uniteti" ka punësuar 20 romë dhe ashkali, banorë të Mëhallës Rome, me mbështetje të Këshillit Danez për Refugjatë (DRC). Në Istog/Istok, në kornizën e "Projektit të Kthimit dhe Rintegritimit" të sponsoruar nga UNDP-ja, disa egjiptian ishin punësuar në rindërtimin e shtëpive në fshatin Serbobran/Srbobrane.

³⁶ Fushatat e vetëdijesimit nuk kanë cak vetëm komunitetet, por tërë popullsinë.

³⁷ Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Novo Brdo/Novobërdë, Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Klinë/Klina, Mitrovicë/Mitrovica, Istog/Istok, dhe Gjakovë/Đakovica.

³⁸ Për shembull, komuna e Ferizajt/Uroševac ndërtoi një qendër të re shëndetësore dhe ndërtoi sistemin e kanalizimit në lagjet Sallahane/Salahane dhe Dubravë/Dubrava, kryesisht të banuara nga Ashkalitë; rrugët ishin asfaltuar dhe kanalizimet ishin riparuar në Gjilan/Gnjilane dhe Viti/Vitina; janë ofruar ilaçet esenciale në *ambulantë* (qendrën shëndetësore) në Mëhallën Rome në Mitrovicë/Mitrovica, derisa mjekët qëndrojnë aty tri herë në javë.

Duke iu referuar **kthimit dhe riintegrimin**, duke përfshirë riatdhesimin, Plani i Veprimit i kërkon institucioneve përgjegjëse komunale të bashkëpunojnë me nivelin qendror për të përforcuar sistemin e grumbullimit dhe përpunimit të informatave mbi komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, si dhe për hartimin e politikave përkatëse dhe për të siguruar shërbime efektive për trajtimin e nevojave të personave të riatdhesuar. Megjithatë, ka pasur pak përparim në nivelin lokal në kuptimin e hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe programeve të orientuara kah trajtimi i nevojave të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të zhvendosur. Qasja në j pronë dhe riposedim të saj mbetet e vështirë dhe vazhdon të pengojë procesin e kthimit, pasi që mungesa e titujve adekuatë pronësorë është dominuese tek shumë romë, ashkali e Egjiptian.³⁹

Komunat nuk kanë ndërmarrë veprime në trajtimin e nevojave specifike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të **riatdhesuar** me forcë në Kosovë - kryesisht nga vendet e Evropës Perëndimore - për të siguruar qasje të barabartë në shërbime. Prapë, kjo është kryesisht rezultat i komunikimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, këto të fundit shpesh të panjofuara me përgjegjësitë e tyre nga Plani i Veprimit dhe Strategjia e Rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Në përgjithësi, zyrtarët komunalë nuk i konsiderojnë personat e riatdhesuar si kategori e veçantë, si dhe dështojnë të miratojnë politika apo programe përkatëse. Në kuptimin e kësaj mungese, gjendja është edhe më brengosëse kur bëhet fjalë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, për shkak të vështirësive me të cilat ata përballen në lidhje me **regjistrimin civil**. Shumë pak është implementuar në këtë drejtim, edhe pse Plani i Veprimit veçanërisht kërkon nga komunat të inkurajojnë dhe shpejtojnë procesin e regjistrimit përmes fushatave vetëdijesuese si dhe deklarimin e muajve të regjistrimit të lirë, siç parashikohet me Planin e Veprimit.⁴⁰ Në kohën e shkrimit, vetëm tri komuna kishin shpallur muajin e regjistrimit të lirë⁴¹ dhe vetëm dy komuna⁴² kishin themeluar borde shqyrtimi për t'i mundësuar individëve pa dokumente fare që të regjistroheshin.

Fushat si **pjesëmarrja dhe përfaqësimi, kultura, mediat dhe informimi** kryesisht janë lënë anash nga institucionet lokale pa zbatim të veprimeve të konsiderueshme nga ana e komunave.

Është pozitive, që aktorët e **shoqërisë civile** kanë marrë iniciativë në disa komuna, duke hartuar plane lokale të veprimit dhe duke u angazhuar në procese konsultative me përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, mediat dhe zyrtarë komunale, për të nxitur implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.⁴³ Një numër iniciativash pozitive për promovimin e qasjes ndaj regjistrimit civil të komunitetit rom, ashkali dhe

³⁹ Për shembull, përkundër përpjekjeve të ZKM-së apo MKK-së, komuna e Mitrovicës/Mitrovica nuk ka ndarë tokë për 99 vjet për rivendosjen e romëve dhe ashkalive nga kampet e kontaminuara me plumb në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe komunën e Leposavić/Leposaviqit në Mëhallën Rome në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica.

⁴⁰ Plani i Veprimit udhëzon që “gjitha komunat të shpallin një herë në vit muajin e regjistrimit civil falas, për personat e peregjistruar dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor”.

⁴¹ Ferizaj/Uroševac, Štrpce/Shtërpçë dhe Prizren. Sipas kryesuesit të Komitetit të Komuniteteve në Suharekë/Suva Reka, kjo komunë gjithashtu ka shpallur muajin e regjistrimit falas, por informata nuk është konfirmuar nga Qendra e Regjistrimit Civil. Derisa komuna e Ferizajt/Uroševac dhe ajo e Štrpce/Shtërpçës nuk kanë të dhëna mbi rezultatet e iniciativës, në Prizren nuk ka aplikuar asnjë pjesëtar i komunitetit rom, ashkali apo egjiptian për regjistrim.

⁴² Istog/Istok, dhe Klinë/Klina.

⁴³ Në Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, dhe Prizren. Hartimi i planeve lokale të veprimit përgjithësisht është iniciuar dhe mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, me përfshirje të organizatave joqeveritare, zyrtarëve komunalë dhe përfaqësues të komuniteteve.

egjiptian, janë zhvilluar dhe zbatuar nga organizatat e shoqërisë civile. Programi për të Drejta Civile në Kosovë (CRPK) ka qenë qenësor në mbështetjen e institucioneve lokale në lehtësimin e regjistrimit civil të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.⁴⁴ Për më tepër, komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian kanë qenë në gjendje t'i qasen regjistrimit civil falas në gjitha komunat përmes mbështetjes së CRPK-së, ose nga vetë komuna në rastet kur personi përjashtohet nga pagesa e tarifës për shkak të të qenit rast social. Në rastet tjera, aktorët e shoqërisë civile kanë bashkëpunuar dhe kanë mbështetur zyrtarët komunalë në ndërmarrjen e fushatave me cak rritjen e vijueshmërisë shkollorë të nxënësve romë, ashkali apo Egjiptian.⁴⁵ Në ato komuna ku shoqëria civile ka marrë iniciativën, janë shënuar prova pozitive të angazhimit e mobilizimit të komunitetit me Strategjinë dhe qëllimet e saj. Kjo paraqet zhvillim pozitiv në një pasqyrë që ndryshe është zhgënjyese të angazhimit në nivel komunal.

4. PËRFUNDIM

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë dokumente politikash të sofistikuar dhe ambicioze, të cilat synojnë integrimin e plotë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, në bazë të parimeve të barazisë. Megjithatë, implementimi i tyre, qoftë në nivel qendror apo atë lokal, ngec mbrapa zotimeve të theksuara me Planin e Veprimit. Korniza institucionale e vendosur për të siguruar implementimin e Planit të Veprimit nuk ka qenë në gjendje të kryejë plotësisht rolin e saj bashkërendues dhe mbikëqyrës, derisa janë bërë arritje modeste nga ministri kryesore përkatëse. Megjithatë, janë bërë disa përpjekje nga institucionet e nivelit qendror për të siguruar që komunat të jenë mjaft të informuara për përmbajtjen dhe masat e parashikuara me Strategji dhe Plan Veprimi, derisa mekanizmat përkatës të bashkërendimit kanë dështuar në sigurimin e komunikimit formal mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal. Vijimisht, komunat mbeten të painformuara për përgjegjësitë e tyre për shkak të mungesës së procedurave qartësuese e udhëzuese të nivelit qendror dhe ndarjes së qartë të përgjegjësiave.

Miratimi i vonshëm i Planit të Veprimit në dhjetor të vitit 2009 nuk i ka lejuar ministrinë dhe komunat të ndajnë fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për implementim në vitin 2010. Përveç kësaj, përfaqësuesit ministrorë dhe komunalë të intervistuar për këtë raport nuk kanë theksuar ndonjë synim që të kërkojnë fonde specifike për implementimin e Strategjisë për vitin 2011, duke hedhur dyshime tjera për qëndrueshmërinë e saj.

Përfaqësimi i romëve, ashkalive e egjiptianëve është siguruar në gjithë mekanizmat e vendosur për mbikëqyrjen e implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit që del nga ajo, por dyshimet në lidhje me kapacitetin e tyre efektiv për të përfaqësuar komunitetet e tyre janë hedhur nga disa anëtarë komunitetesh. Mungesa e perceptuar e konsultimeve mes komuniteteve gjatë fazës së hartimit të Planit të Veprimit dobëson përkushtimin e tyre në ndërmarrjen veprimeve dhe iniciativave përkatëse, si dhe çon në mungesë të pronësisë në anën e komuniteteve.

⁴⁴ Aktivitetet e zbatuara nga CRPK përfshijnë fushata për ngritje të vetëdijes në televizion dhe radio apo përmes vizitave derë-më-derë, takimeve, shtypjes dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve, broshurave dhe afisheve.

⁴⁵ Në këto komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prizren, dhe Rahovec/Orahovac.

Implementimi i iniciativave dhe masave në fushat e kthimit dhe riintegritimit, kulturës dhe arsimit, janë zhvillime pozitive drejt sigurimit të integritetit të qëndrueshëm të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës. Vlen të përmendet mbyllja e kampit të kontaminuar të Qeshmin Llugut në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, e shumëpritur për më se 11 vjet, paraqet një arritje themelore në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të këtyre komuniteteve. Përveç këtyre, ka sinjale që do të gjenden zgjidhje të qëndrueshme edhe për ata romë dhe ashkali që jetojnë të zhvendosur në kampet ende ekzistuese në veri të Kosovës, si dhe të cilët vuajnë nga nivele të larta të kontaminimit me plumb.

Në anën tjetër, ka nevojë urgjente që të sigurohet që implementimi i Strategjisë të përfshijë edhe ata sektorë që gati plotësisht janë neglizhuar deri tani. Duhet ndërmarrë përpjekje serioze dhe konkrete për të trajtuar gjendjen ekonomike të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, për të rritur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në jetën publike, si dhe për të siguruar qasje të plotë dhe të papenguar ndaj dokumenteve personale, shërbimeve shëndetësore, banimit dhe pronës. Vëmendje e veçantë kërkohet për të kthyerit dhe njerëzit e riatdhesuar me forcë për të siguruar riintegrimin e tyre të qëndrueshëm.

Strategjia dhe Plani i Veprimit paraqesin hapa të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie shumetnike, ku të drejtat e të gjithëve njihen dhe respektohen. Shkalla e kufizuar e implementimit të tyre mbetet përkujtues i fuqishëm i punës së madhe që duhet kryer për të siguruar mbrojtjen e komuniteteve më të cenuara në Kosovë.

5. REKOMANDIMET

Duke e marrë parasysh të mësipërmen, OSBE-ja i këshillon hisedarët përkatës që t'i marrin në konsideratë rekomandimet në vijim.

Për ZKM-në dhe ministritë e linjës:

- Ta fuqizojnë zotimin që është dhënë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Strategji dhe Planin e saj të Veprimit duke u siguruar që vullneti politik dhe resurset e nevojshme të ndahen dhe të jenë në dispozicion në të gjitha nivelet e qeverisë.
- Të ndahen resurset përkatëse nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe të implementohen pa vonesë të mëtutjeshme ato aktivitete për të cilat nuk nevojiten resurse financiare.
- Të përkrahet puna e Komitetit dhe e Grupit Punues si mekanizma kryesor për koordinimin e implementimit dhe monitorimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit me vëmendje të veçantë në pjesëmarrje të komuniteteve.
- Të përmirësohet komunikimi ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe atij qendror për të garantuar një nivel të mjaftueshëm të koordinimit ndërmjet të gjitha institucioneve dhe hisedarëve të përfshirë.
- Të identifikohen nevojat më urgjente të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke u siguruar resurset për t'u kompletuar aktivitetet tashmë të nisura të mbledhjes së të dhënave dhe duke u angazhuar njëkohësisht në ushtrime të ngjashme në sektorët e lënë pas dore.
- Të angazhohen në sektorët më së shumti të lënë pas dore, siç është pjesëmarrja, përfaqësimi, punësimi dhe fuqizimi ekonomik, si dhe të sigurohet qasja e plotë dhe e papenguar në dokumente personale, shërbime të kujdesit shëndetësor, banim dhe pronë.

- Të sigurojnë kthimin dhe rivendosjen e qëndrueshme të të gjithë romëve të zhvendosur në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën Veriore dhe të ofrohet trajtimi përkatës shëndetësor.
- Ta sigurojnë implementimin e kurrikulës në gjuhën rome të përkrahur nga MASHT-i përmes ofrimit të teksteve mësimore dhe trajnimit të mësimdhënësve.

Për Komitetit dhe Grupin Punues:

- Ta sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit përmes raporteve të progresit me mandat.
- Ta përmirësojnë koordinimin dhe komunikimin ndërmjet ministrive përkatëse, si dhe ndërmjet institucioneve tjera, donatorëve dhe shoqërisë civile.
- Të ndërmarrin aktivitetet me qëllim të vetëdijesimit të hisedarëve përkatës, si dhe të publikut në përgjithësi në lidhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

Për zyrtarët komunalë:

- Të kërkojnë në mënyrë proaktive informata dhe përkrahje nga ministrinë përkatëse të linjës në lidhje me përgjegjësitë komunale të parapara në Strategji dhe Plan të Veprimit..
- Të sigurojnë ndarjen e fondeve të mjaftueshme për implementimin e aktivitetet me prioritet të parapara në Plan të Veprimit gjatë rishikimit gjashtëmuor të buxheteve komunale në qershor të vitit 2011, duke ndarë resurse adekuate për implementimin e vazhduar të tyre në buxhetin e vitit 2012.
- Ta promovojnë shpërndarjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit te zyrtarët përkatës komunalë, posaçërisht nëpër zyrat komunale për komunitete dhe kthim, dhe të ndërmarrin nisma për t'iu qasur komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për ta siguruar vetëdijesimin dhe pjesëmarrjen e tyre.
- Të shpallin një herë në vit muajin e regjistrimit civil pa pagesë për personat e paregjistruar dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor.
- Të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe ta përkrahin atë në punën e saj rreth angazhimit dhe mobilizimit të komuniteteve në lidhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit.
- Ta përkrahin zhvillimin e planeve lokale të veprimit për implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në nivel komunal.

Për përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian:

- Të kërkojnë informata për përmbajtjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe të promovojnë vetëdijesimin, avokimin dhe veprimet për implementimin brenda institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe në mesin e vetë komuniteteve.

Për agjencitë ndërkombëtare:

- T'i nxisin dhe përkrahin institucionet e Kosovës për t'i implementuar me kohë dhe në tërësi Strategjinë dhe Planin e Veprimit.